

**UDHËZIM**  
**Nr.12, datë 24.5.2005**

**PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR CAKTIMIN E MANDATIT TË  
FUNDIT NGA LISTAT SHUMEMËRORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E  
SHQIPËRISË TË VITIT 2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2005, me pjesëmarrjen e:

|                   |         |
|-------------------|---------|
| Ilirjan Celibashi | Kryetar |
| Tomor Malaj       | Anëtar  |
| Klement Zguri     | Anëtar  |
| Dëshira Subashi   | Anëtare |
| Pandeli Varfi     | Anëtar  |
| Çlirim Gjata      | Anëtar  |
| Dodë Prenga       | Anëtar  |

Në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 67 pikat “b”, “ç”, “dh” dhe nenit 68 pikat “a” dhe “ç” të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**UDHËZON:**

Neni 1  
**Qëllimi**

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat e organizimit të shortit, midis subjekteve zgjedhore që kanë mbetje dhjetore të barabarta, për caktimin e mandatit të fundit nga listat shumëmemërore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2005.

Neni 2

1. KQZ merr vendim për organizimin e shortit në rastet e parashikuara në nenin 67 pikat “b”, “ç” dhe “dh” dhe nenin 68 pikat “a” dhe “ç” të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Procedurat e shortit organizohen jo më herët se 5 ditë nga marrja e vendimit për shortin. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit shpallet në hyrje të KQZ-së.

Neni 3

1. Hedhja e shortit organizohet në seancë publike.

Neni 4

1. Në datën dhe orën e caktuar për organizimin e shortit, sekretari i KQZ-së sigurohet paraprakisht për praninë e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore përkatëse dhe i fton ato të zënë vendet e caktuara.

2. Në një enë transparente futen aq gogla sa është edhe numri i subjekteve zgjedhore, pjesëmarrëse në short.

3. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre ku në njërin prej tyre shënohet fjala “FITUES”.

4. Radha e tërheqjes së goglave sipas pikës 2, caktohet me short.

5. Sekretari i KQZ-së fton me radhë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore për tërheqjen e shortit.

6. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore midis të cilëve hidhet shorti, nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast procedura për tërheqjen e shortit për subjektin në

mungesë, bëhet nga një person i caktuar me vendim të KQZ-së.

#### Neni 5

1. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor që e hap gogllën, ia dorëzon sekretarit të KQZ-së, i cili e lexon me zë të lartë dhe ua tregon të gjithë përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short.

2. Pasi është tërhequr gogla me shënimin “FITUES”, sekretari i KQZ-së i hap me radhë goglat e mbetura në enë, nëse ka, dhe lexon me zë të lartë përmbajtjen e fletëve dhe ua tregon ato me radhë pjesëmarrësve në mbledhje.

#### Neni 6

Në përfundim të procedurës së hedhjes së shortit, KQZ-ja merr vendim për shpalljen e rezultatit të shortit.

#### Neni 7

#### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.